



PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE DHE BAMIRËSIA E QYTETARËVE TË
KOMUNAVE BËRVENICË, ZHELINË, SARAJ DHE TEARCË

Projekti: Investimet me ndikim shoqëror në komunitete

Botues

Fondacioni për zhvillimin e arsimit dhe kulturës Albiz

Për botuesit:

Besir Dernjani, drejtor ekzekutiv

Autor

Gonce Jakovleska

Dizajni

Fondacioni Albiz

Shkup, qershor, v. 2022

Kontakti

Fondacioni për zhvillimin e arsimit dhe kulturës Albiz

Rr. 20 nr. 97, Saraj, 1000 Shkup

Tel. +389/2 2057-632 Faksi: +389/2 2057-632

Ueb faqja: www.albiz.org.mk

Posta elektronike: info@albiz.org.mk

- Ky publikim është përgatitur nga Fondacioni Albiz për zhvillimin e arsimit dhe kulturës, me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinione të shprehura në këtë publikim „Përgjegjësia shoqërore dhe bamirësia e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë“ i takojnë autorit dhe Fondacionit Albiz dhe nuk i shprehin opinionet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Hyrje

- Në këtë raport janë analizuar konstatimet e anketës „Përgjegjësia shoqërore dhe bamirësia e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë“, e cila u zbatua në ekzemplarin përfaqësues të qytetarëve në këto katër komuna. Ky hulumtim kishte për qëllim që t'i shqyrtojë pikëpamjet e qytetarëve lidhur me çështjet e përgjegjësisë shoqërore dhe bamirësisë. Fondacioni Albiz, ia besoi anketën e opinionit publik, në të cilën bazohet ky raport, Agjencisë hulumtuese M-Prospekt, si përgjegjësi e së cilës ishte edhe korrektësia metodologjike e saj.
- Ky hulumtim zbatohet për herë të parë dhe në të mungojnë pikat referuese për krahasimin e rezultateve me hulumtimet e mëparshme.

Metodologjia dhe qasja

- Hulumtimi u realizua me anë të anketës telefonike, duke përdorur metodën CATI, të ekzemplarit të rastësishëm nga 811 të anketuar në katër komuna rurale (N=200 në çdo komunë). Marzha e gabimit është $\pm 7\%$, me nivelin e besimit prej 95%.
- Të dhënat u mblodhën gjatë periudhës prej 17 deri më 26 maj të vitit 2022. U përfshinë katër komuna rurale – Saraj, Tearcë, Bërvenicë dhe Zhelinë.
- Përzgjedhja e të anketuarit u bë duke përdorur metodën „Datëlindja vijuese“ për numrat fiks, ndërsa për numrat celularë u anketua personi që iu përgjigj thirrjes telefonike. Në hulumtim morën pjesë të anketuarit e moshës mbi 18 vjeç.

Pyetëtori

- Përgatitja e pyetëtorit ishte përgjegjësi e agjencisë hulumtuese e cila pyetjet i bazonte nga përvojat e mëparshme dhe hulumtimet e përgjithshme në këtë fushë.

Mostra

- Korniza e popullsisë së mostrës ishte popullata më e vjetër se 18 vjeç, ndërsa kriteret e përfaqësimit ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, arsimi, statusi i punës dhe vendbanimi.
- Nga 811 të anketuar, 51,7% janë gra, ndërsa 48,3% janë burra. Në pikëpamje të moshës, 21% janë ndërmjet 18 dhe 29 vjeç, 18,7% janë të moshës prej 30 deri në 39 vjeç, 20,3% janë ndërmjet 40 dhe 49 vjeç, 19,5% janë të moshës prej 50 deri në 64 vjeç, 20,5% janë më të vjetër se 65 vjeç. Sa i përket përfaqësimit etnik, 83% e të anketuarve janë shqiptarë etnikë, 16,2% janë maqedonas etnikë, ndërsa pjesa tjetër kanë deklaruar se janë të një përkatësisë tjetër etnike. Pothuajse gjysma e të anketuarve janë me arsim të mesëm (44,9%). Me arsim fillor të kryer janë 29,6%. Me arsim të lartë të kryer janë 10,0%, ndërsa me shkollë të lartë janë 8,5% e të anketuarve. Me arsim fillor të papërfunduar janë 5,4% e të anketuarve. Më shumë se një e pesta e të anketuarve (21,5%) janë të punësuar në institucion privat, ndërsa 10,4% janë të punësuar në institucion publik. Të papunë janë 21,7%, të pensionuar janë 16,0%, ndërsa 13,6% janë të angazhuar në detyra shtëpiake. Përmbledhja e plotë e mostrës është dhënë në shtojcë.


Përpunimi dhe shfaqja e rezultateve

- Të dhënat e mbledhura u përpunuan sipas dendësisë dhe proporcionit të përgjigjeve. Të dhënat janë me nivelin e besimit prej 95 % dhe me gabim prej $\pm 7\%$. Rezultatet tregohen nëpër grafikë në nivel të mostrës së tërë. Përveç me grafikë, të dhënat tregohen edhe në numra.

• I PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E QYTETARËVE

- Në zhvillimin e shoqërisë rol të rëndësishëm luan përgjegjësia e qytetarëve, ndikimi dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e problemeve. Çdo shoqëri funksionale ka nevojë për qytetarë aktivë dhe me përgjegjësi shoqërore. Kjo pjesë e hulumtimit i verifikon qëndrimet e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë lidhur me përgjegjësinë për problemet shoqërore në komunitete, për përgjegjësinë e qytetarëve dhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve shoqërore. Krahas kësaj, i verifikon qëndrimet e solidaritetit të qytetarëve dhe frymës publike të shprehura përmes opinioneve në lidhje me arsyetimin e mospagimit të tatimit. Disa nga pyetjet kanë të bëjnë me veprimet në komunitet dhe pjesëmarrjen e të anketuarve në to, fushat në të cilat japin ndihmesë dhe mënyrat e ofrimit të ndihmës.
- Një e treta e qytetarëve (33,0%), banorë të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë konsiderojnë se shteti është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve në komunitetin e tyre. Diçka më i vogël (27,9%) është numri i atyre që e vendosin përgjegjësinë në komunë, ndërsa për 11,6% përgjegjësia bie te qytetarët. Një përqindje shumë e vogël (6,4%) përgjegjësinë e shikojnë te sipërmarrjet, ndërsa për 18,9% përgjegjësia duhet ndarë, respektivisht, të gjithë të përmendurit janë përgjegjës. Kjo gjë tregon se shumica e qytetarëve (60,9%) presin mbështetje institucionale për tejkalimin e problemeve të tyre, pa dallim se a është ajo shtetërore a komunale.


Grafiku 1. Përgjegjësi për problemet shoqërore në komunitet



Nuk ekzistojnë shmangiet domethënëse që kanë të bëjnë me karakteristikat demografike e të anketuarve. Megjithatë, mund të vërehet se shqiptarët etnikë (34,9%) presin më tepër nga shteti, për dallim nga maqedonasit etnik (15,3%). Në anën tjetër, një numër më i madh i maqedonasve etnik (38,2%) përgjegjësinë e vendosin te të gjithë faktorët, për dallim nga 15,3% e shqiptarëve etnik.


- Gjatë krahasimit të rezultateve, te katër komunat mund të vërehen disa dallime: pritshmëria nga shteti është më e lartë në komunën e Sarajit (39,5%), ndërsa më e ulët në komunën e Bërvenicës (29,5%); në Zhelinë kanë pritshmëri më të lartë nga komuna (36,5%), për dallim nga banorët e komunës së Bërvenicës ku pritshmëria nga kjo komunë është 22,0%; në komunën e Bërvenicës, çdo i katërti qytetar (25,5%) përgjegjësinë e vendos te të gjithë të përmendurit, për dallim nga banorët e komunës së Bërvenicës ku pothuajse çdo i dhjeti (9,5%) ka pritshmëri të këtillë.
- Mendimi i qytetarëve ndodhet në të njëjtën linjë kur bëhet fjalë për mënyrat e zgjidhjes së nevojave shoqërore. Numri më i madh i tyre (46,0%) konsiderojnë se kjo mund të bëhet duke kërkuar përgjegjësi nga shteti dhe duke ndikuar në politikat publike. Për rreth një të tretën (31,2%) dalja ndodhet tek zhvillimi, arsimit dhe aftësimi i qytetarëve, e pothuajse për një të pestën (21,0%) është ndihma sociale dhe humanitare e grupeve në nevojë.

Grafikiku 2. Mënyrat e zgjidhjes së nevojave shoqërore




- Edhe në përgjigjet e kësaj pyetjeje mund të shihet dallimi ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Të parët (41,2%) më shpesh i kanë dhënë përparësi zhvillimit, arsimit dhe aftësimin të qytetarëve për dallim nga këta të dytit (29,1%). Krahas kësaj, në përgjigjet ka ndikuar edhe arsimi i të anketuarve. Mbështetja për zhvillimin, arsimin dhe aftësimin e qytetarëve rritet me rritjen e nivelit arsimor të të anketuarve prej 22,7% te ata me arsim fillor të pakryer deri në 55,6% e të anketuarve me arsim të lartë të kryer. Në drejtim të kundërt ndodhet mbështetja e ndihmës sociale dhe humanitare për grupet në nevojë prej 27,3% te të anketuarit me arsim fillor të pakryer në 16,0% te ata me arsim të lartë të kryer.
- Vështruar sipas komunave, shumica e qytetarëve të Zhelinës (53,0%) konsiderojnë se kërkesa e përgjegjësisë nga shteti dhe ndikimi i politikave publike është mënyrë për tejkalimin e nevojave të qytetarëve. Më shumë se 10 pikë përqindjeje (pp) është dallimi me banorët e komunës së Sarajit (41,5%) te kjo përgjigje. Pothuajse është i njëjtë dallimi ndërmjet komunave Tearcë (36,0%) dhe Zhelinë (26,5%) kur bëhet fjalë për zhvillimin, arsimin dhe aftësimin e qytetarëve. Sa i përket mbështetjes sociale dhe humanitare për grupet në nevojë, banorët e Sarajit (28,0%) janë mbështetësit më të mëdhenj të kësaj mënyre të zgjidhjes së nevojave për dallim nga banorët e Bërvenicës (16,0%).
- Opinionet e të anketuarve për përgjegjësitë e qytetarëve janë të ndara. Numri më i madh i tyre, 37,9% konsiderojnë se është përgjegjësi e qytetarëve që t'i respektojnë ligjet dhe detyrimet ligjore. Për 23,0% kjo është pjesëmarrja në aktivitetet mirëbërëse, ndërsa diçka më e ulët është pjesëmarrja në aktivitetet vullnetare në komunitete (19,7%) dhe pjesëmarrja në aktivitete politike jopartiake (18,6%).
- Respektimi i detyrimeve ligjore më tepër njihet nga gratë si obligim qytetar sesa nga burrat. Më shpesh studentët e njohën këtë përgjegjësi qytetare në raport me të anketuarit e tjerë, veçanërisht të punësuarit në institucionet private. Te përgjigjet për pjesëmarrje në aktivitetet bamirëse ka ndikuar arsimi, kështu që ata me arsim të lartë në përqindje më të madhe i njohin këto aktivitete si obligim qytetar. Sa i përket pjesëmarrjes në aktivitetet vullnetare në komunitet, studentët (51,0%) më shpesh e kanë njohur si përgjegjësi qytetare, ndërsa të punësuarit në institucionet publike dhe private janë më të shumtët në mesin e atyre të cilët pjesëmarrjen në aktivitete politike jopartiake e konsiderojnë si përgjegjësi qytetare.

Grafiku 3. Përgjegjësia e qytetarëve




- Shumica e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë (61,2%) besojnë se njerëzit janë solidarë dhe të gatshëm për t'i ndihmuar ata që kanë nevojë për ndihmë. Diçka më tepër se një e treta (37,7%) kanë mendim të kundërt, respektivisht mendojnë se njerëzit kujdesen vetëm për veten dhe nuk janë të interesuar për të tjerët.
- Qëndrimet për solidaritetin janë diametralisht të kundërta te maqedonasit etnik dhe shqiptarët etnik. Përderisa shumica e shqiptarëve etnik (66,9%) besojnë në solidaritetin tre njerëzit, pothuajse numri i njëjtë i maqedonasve etnikë (67,9%) konsiderojnë se njerëzit kujdesen vetëm për veten. Dallimet mund të shihen edhe në raport me statusin e punës, andaj të punësuarit në institucionet publike (73,8%) shumë më tepër besojnë në solidaritetin e njerëzve për dallim të atyre të punësuar në institucionet private (54,0%).

Grafiku 4 Qëndrimet për solidaritetin e njerëzve



- Banorët e Bërvenicës kanë nivel më të lartë besimi në njerëzit dhe solidaritetin e tyre në raport me banorët e tre komunave të tjera dhe kjo rezulton 45,5% për dallim nga ajo e banorëve të Sarajit e cila është 34,0%.
- Në pyetjen sa a është e arsyeshme për ju që t'i shmangeni pagesës së tatimit? – nuk ka përgjigje të shumicës. Rreth 40,0% e qytetarëve ishin kategorik dhe thanë se nuk arsyetohet asnjëherë, përderisa një e treta (33,4%) lënë rezervë dhe thonë se ndonjëherë arsyetohet të mos paguhet tatimi. Nuk është për t'u nënvlerësuar numri (17,6%) i atyre të cilët thanë se mospagesa e tatimit çdoherë arsyetohet. Nëse merret parasysh statusi i punës, më të shumtë në mesin e atyre që thanë se mospagesa e tatimit çdoherë arsyetohet janë bujqit (31,6%), ndërsa ndër ata të cilët herë pas here arsyetojnë një sjellje të tillë janë të papunësuarit (42,0%).
- Edhe në konstatimet e kësaj pyetjeje mund të shihet dallimi në dy etnitë e ndryshme. Mbi dy të tretat e maqedonasve etnikë thonë se mospagesa e tatimit asnjëherë nuk arsyetohet, për dallim nga rreth një e treta e shqiptarëve etnikë. Shmangia e pagesës së tatimit ndonjëherë arsyetohet për 38,2% të shqiptarëve etnikë për dallim nga 9,2% të maqedonasve etnikë.


Grafiku 5 Arsyeshmëria për mospagesën e tatimit



- Nga krahasimi i përgjigjeve sipas komunave mund të shihet se banorët e Bërvenicës (24,0%) më shpesh e kanë zgjedhur përgjigjen „çdoherë“, për dallim nga ata të Zhelinës (13,0%). Edhe në zgjedhjen e përgjigjes „ndonjëherë“, dallimi më i madh është ndërmjet banorëve të komunës së Zhelinës (38,5%) dhe Bërvenicës (23,0%), mirëpo në kahje të kundërt, respektivisht qytetarët e Zhelinës më shpesh konsiderojnë se shmangia e tatimit ndonjëherë është e arsyeshme për dallim nga banorët e Bërvenicës. Këtu janë edhe më se kategorikë për pa arsyeshmërinë e mospagesës së tatimit, për dallim me komunat e tjera. Për këtë përgjigje janë shprehur 45,5% të banorëve të Bërvenicës për dallim nga 35,5% të banorëve të Sarajit.
- Pothuajse gjysma e qytetarëve (49,7%) u përgjigjën negativisht në pyetjen „Vallë gjatë 12 muajve të kaluar ka pasur takime në të cilat është folur për problemet në bashkësinë tuaj lokale /komunën?“ Për dallim prej tyre, rreth një e treta (34,3%) deklaruan se takime të tilla ka pasur, përderisa 15,2% e qytetarëve të katër komunave nuk dinë se a janë mbajtur aktivitete të tilla.


- Te kjo pyetje mund të shihen dallime edhe në kuptimin gjinor. Kështu, burrat (41,3%) më shpesh kanë dhënë përgjigje pohuese në këtë pyetje se sa gratë (27,7%). Gjithashtu, gratë janë më pak të informuara për mbajtjen e këtyre ngjarjeve, respektivisht ato më shpesh e kanë zgjedhur përgjigjen „nuk e di“ (21,0%) për dallim nga burrat (8,9%). Edhe mosha ka pasur ndikim në përgjigjet, andaj të anketuarit të cilët janë në vitet më produktive të jetës, përkatësisht ndërmjet 30 dhe 49 vjeç më shpesh janë përgjigjur me „po“ (46,7%, respektivisht 43,6%).
- Edhe një dallim tjetër buron nga karakteristikat demografike e të anketuarve, respektivisht nga përkatësia etnike e tyre kështu që, shqiptarët etnikë kanë qenë më të sigurt në përgjigjet dhe 38,3% prej tyre deklaruan se ka pasur takime të tilla, ndërsa 11,9% thanë se nuk e dinë. Për dallim prej tyre, 14,5% e maqedonasve etnikë thanë se ka pasur takime të tilla, ndërsa thuajse një e treta ose 32,8% thanë se nuk e dinë. Përgjigjja pohuese rritet edhe me shkallën e arsimit të anketuarve prej 22,7% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri në 40,7% te ata me arsim të lartë të kryer.

Grafiku 6 Takimet për problemet në komunitet në 12 muajt e fundit




- Të dhënat e grupuara sipas komunave tregojnë se banorët e komunës së Zhelinës (38,5%) më shpesh u përgjigjën me „po“ për dallim nga banorët e komunës së Bërvenicës (27,5%). Nuk ka dallime të mëdha të dy përgjigjet e tjera.
- Prej tyre gati se një e treta që deklaruan se ka pasur takime të tilla në komunitet, gjithsej 23,2% e qytetarëve kanë marrë pjesë një herë apo disa herë. Pavarësisht se e dinin se ka pasur takime, 8,3% nuk morën pjesë në to. I parëndësishëm është numri i atyre të cilët kanë marrë pjesë disa herë dhe arrin vetëm 2,7%.
- Në grafikun 7 mund të shihet se edhe pse numri i atyre të cilët deklaruan se njerëzit e komunitetit të tyre u organizuan vullnetarisht për të bërë diçka të dobishme në 12 muajt e fundit është më i larti, megjithatë ata nuk janë shumica. Diçka më shumë se një e treta (36,9%) u përgjigjën me jo, ndërsa është pothuajse identik numri i atyre që thanë se nuk e dinë (16,4%) me përgjigjet e pyetjes së mëparshme. Nuk ka dallime domethënëse të bazuara në karakteristikat demografike të anketuarve, apo të tilla të cilat burojnë nga karakteristikat gjeografike.
- Të pyetur vallë dhe sa kanë marrë pjesë personalisht në aktivitetet e këtilla, rreth një e katërta (24,9 %) thanë se kanë marrë pjesë një herë apo disa herë. Është i vogël numri i atyre të cilët kanë marrë pjesë shumë herë dhe rezulton 3,8%. Nga ata 46,0% të cilët thanë se njerëzit e komunitetit të tyre organizoheshin vullnetarisht, 16,6% nuk morën pjesë në ato aktivitete.

Grafiku 7 Vetëorganizimi vullnetar i njerëzve në komunitet në 12 muajt e fundit.




- Shumica e qytetarëve (53,3%), vullnetarisht, përkatësisht pa kompensim, personalisht i kanë ndihmuar komunitetit të vet, përderisa 44,4% u përgjigjën negativisht. Numrin më të madh të atyre që kanë ndihmuar personalisht e përbëjnë burrat, respektivisht 59,7% e tyre për dallim nga 47,3% të grave. Edhe moshë ndikonte në përfshirjen e ndihmës së komunitetit. Ndihmesa rritet me rritjen e moshës së të anketuarve prej 47,1% te ata ndërmjet 18 dhe 29 vjeç deri në 58,9% te ata të moshës prej 50 deri në 64 vjeç. I njëjtë është edhe ndikimi i arsimit, ashtu siç rritet niveli arsimor, ashtu rritet numri i atyre të cilët i ndihmojnë komunitetit prej 38,6% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri në 61,7% me arsim të lartë të kryer.

Grafiku 8 Ndhimja personale në komunitet pa kompensim




- Nga aspekti i përkatësisë etnike, maqedonasit etnikë më shpesh kanë ndihmuar në komunitet (63,4%) për dallim nga shqiptarët etnikë (51,7%). Mund të shihen dallimet edhe nga aspekti i statusit të punës së të anketuarve. Mbështetje dhe ndihmë më të madhe komunitetit i kanë dhënë të punësuarit në sektorin publik (69,0%), në raport me ata të sektorit privat (57,5%), e veçanërisht në raport me bujqit (42,1%) dhe të angazhuarit në obligimet shtëpiake (40,9%).
- Të anketuarit të cilët ishin të përfshirë personalisht në ndihmën e komunitetit (53,3%), të pyetur se në cilën fushë kanë ofruar mbështetje, më së shpeshti janë përgjigjur se ato janë kishat dhe komunitetet fetare (13,1%) apo çështjet sociale dhe humanitare (10,4%). Çdo fushë tjetër ka mbështetje e cila është nën 10%. Mbështetje të aktiviteteve për fëmijët dhe të rinjtë ofruan 7,0% prej tyre që ishin të përfshirë, shëndeti e shëndetësia dhe ambienti jetësor janë 3,6%, përkatësisht 3,2%. Mbështetja për personat me nevoja të veçanta dhe komunitetet etnike është e barabartë (2,0%), ndërsa të tjerët janë nën 2%, përkatësisht nën 1%.

Grafiku 9 Fusha në të cilën është ofruar ndihma personale në komunitet



- Nga ata që kanë ofruar mbështetje (53,3%), çdo i pesti qytetar e ka dhënë mbështetjen në para (21,9%), përderisa 15,2% e kanë bërë atë përmes punës vullnetare. Gjithsej 7,6% e të anketuarve kanë paguar anëtarësim, ndërsa 7% kanë marrë pjesë në aktivitetet.

Grafiku 10 Mënyra në të cilën është zbatuar ndihma personale në komunitet



- Nëse analizohen përgjigjet sipas komunave, mund të shihet se punën vullnetare pa ndonjë kompensim më së shpeshti e kanë bërë banorët e komunës së Sarajit (35,7%), për dallim nga banorët e komunës së Zhelinës ku ndihmën e tillë e kanë praktikuar 21,4% e të anketuarve. Ndërkaq në Zhelinë, është më i madh numri i atyre të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete (24,5%) për dallim nga ai në vo Bërvenicë i cili rezulton 7,4%. Këtu, në Bërvenicë, më së shpeshti kanë ofruar mbështetje përmes donacionit me para. Gjithsej 49,6% e atyre që kanë ofruar ndihmë thanë se këtë e kanë bërë me para. Përqindje më të ulët të qytetarëve të cilët kanë ofruar mbështetje me para ka në komunën e Zhelinës (32,7%).

Përfundime

Shteti dhe komuna kanë përgjegjësi më të madhe për zgjidhjen e problemeve shoqërore në komunitet. Shumica e qytetarëve (60,9%) e njohin shtetin dhe komunën si përgjegjës, ndërsa vetëm 11,6% e qytetarëve përgjegjësinë e shohin në veten e tyre.

Problemet mund të zgjidhen duke kërkuar përgjegjësi nga shteti dhe ndikim në politikat publike. Kjo është përgjigja më e shpeshtë e të anketuarve (46,0%). Rrugëdaljen përmes zhvillimit, arsimit dhe aftësimin të qytetarëve e shikojnë 31,2%.

Mendimet për përgjegjësinë e qytetarëve janë të ndara. Numri më i madh i të anketuarve (37,9%) konsiderojnë se respektimi i ligjeve është përgjegjësia kryesore e qytetarëve

Shumica janë ata të cilët konsiderojnë se qytetarët janë solidarë dhe të gatshëm për të ndihmuar. Shqiptarët etnikë më tepër besojnë në solidaritetin e njerëzve.

Nuk ka dënim të shumicës ndaj shmangies së pagesës së tatimit. Gjithsej 51,0% thanë se ndonjëherë ose çdoherë është e arsyeshme të shmanget pagesa e tatimit.

Nuk ka ose qytetarët nuk e dinë se ekzistojnë takime ose aksione për tejkalimin e problemeve në komunitet. Gratë janë më pak të informuara për takimet dhe aksionet në komunitet. Gjithsej 28,7% të paktën një herë kanë marrë pjesë në aksione të këtilla.

Shumica e qytetarëve kanë ndihmuar vullnetarisht në komunitetin e vet. Burrat kanë marrë pjesë më shpesh në aksione të tilla nga gratë. Ndihma zmadhohet me moshën dhe arsimin e të anketuarve.


Tre fushat në të cilat më shpesh ofrohet ndihmë janë: kishat dhe komunitetet fetare, aktivitetet sociale dhe humanitare si dhe fëmijët, të rinjtë dhe studentët.

Paratë janë forma më e zakonshme e donacionit. Në vend të dytë është puna vullnetare.


• II Bamirësia

- Bamirësia e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë është verifikuar përmes donacioneve të qytetarëve në 12 muajt e fundit, duke i verifikuar arsyet e mos dhurimit, qëllimet e dhurimit, llojet e donacioneve dhe shumën e tyre, subjektet e interesit gjatë dhurimit, periudhat kohore të dhurimit, mënyra e parapëlqyer dhe ndërmjetësit gjatë dhurimit. Krahas kësaj, kjo pjesë i përfshin edhe motivet dhe qëllimet e dhurimit, informimin për veprimet në komunitet si dhe qëndrimet për futjen e ndryshimeve teknologjike në procesin e dhurimit. Nëpërmjet disa pyetjeve u verifikua edhe interesi i informatës kthyesë të donatorëve për efektet e donacionit të tyre.
- Shumica e qytetarëve (60,9%) thanë se kanë dhuruar në komunitet 12 muajt e fundit, në anën tjetër, ata të cilët nuk kanë dhuruar këtë periudhë janë 39,1%. Niveli i arsimit dhe statusi i punës kanë ndikuar në përgjigjet e të anketuarve. Numri i atyre të cilët dhuruan shtohet me rritjen e nivelit të arsimit dhe atë prej 47,7% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri në 82,7% te të anketuarit me arsim të lartë të kryer. Parë në prizmin e statusit të punës, më së shumti kanë dhuruar të punësuarit në institucionet publike (72,6%), e më së paku bujqit (42,1%). Nuk ka dallime domethënëse në nivelin e dhurimit te komunat e ndryshme.

Grafiku 11 Donacionet për komunitetin në 12 muajt e fundit




Grafikoni 12 Arsyet e mos dhënies së donacionit në 12 muajt e fundit




- Këta 39,1% e të anketuarve të cilët thanë se nuk kanë dhuruar në 12 muajt e fundit u pyetën për arsyet për këtë gjë. Numri më i madh i tyre ose 15,4% i numrit të përgjithshëm të të anketuarve thanë se nuk kanë mjete të mjaftueshme për të dhuruar. Kjo përgjindje është më e madhe përreth 3,0% nëse merret parasysh se numri më i madh i atyre të cilët kanë dhënë përgjigje tjera në fakt kanë formulime tjetërfare për mungesën e mjeteve siç janë: „situata e vështirë ekonomike“, „unë jam student, nuk kam mjete të mjaftueshme“ dhe ngjashëm.
- Për 5,1 nga të anketuarit arsyeja është mosbesimi se paratë po përdoren siç duhet, ndërsa 2,7% thanë se nuk ka efekt. Gjithsej 2,3% thanë se nuk dinin si të dhuronin.

Grafiku13 Qëllimet e donacioneve në 12 muajt e fundit




- Të anketuarit (60,9%) që kanë dhuruar u pyetën për qëllimet për të cilat dhuruan. Siç mund të shihet në grafikun 13, numri më i madh (29,6%) dhuruan për ndihma humanitare, ndërsa prioriteti i dytë i qytetarëve (14,8%) ishte trajtimi i të sëmurëve. Ndërtimi i objekteve fetare dhe të mbështetjes së komuniteteve fetare ishte qëllimi i 9,0% të donatorëve, kurse të gjitha qëllimet e tjera u mbështetën në numër më të vogël, respektivisht, për përmirësimin e jetës në komunitetin lokal dhuruan 3,9 nga të anketuarit, ndërsa për ndihmën e shkollave 1,6%.

Grafiku 14 Llojet e donacioneve




- Qytetarët më së shpeshti kanë dhuruar para (44,8%). Gjithsej 12,1% kanë dhuruar të mira materiale, përkatësisht ushqim, veshje dhe ngjashëm, ndërsa përmes punës bamirëse, dhuruan vetëm 4,1% e të anketuarve. Me rritjen e moshës rritet numri i të anketuarve që kanë dhënë donacione në para. Rritja është prej 56,9% te më të rinjtë, respektivisht tek të anketuarit e moshës prej 18 deri në 29 vjeç deri në 83,9% tek grupi më i moshuar i të anketuarve, respektivisht ata mbi 65 vjeç.
- Dallimet mund të vërehen në donacionet e grupeve të ndryshme etnike kështu që, maqedonasit etnikë (96,4%) kanë dhuruar para më shpesh se shqiptarët etnikë (68,9%), ndërsa të fundit kanë dhuruar më shpesh mallra (23,3%) sesa bashkëqytetarët e tyre maqedonas etnikë (2,4%).
- Në pikëpamje ta statusit të punës, paratë kanë qenë forma më e shpeshtë e donacionit për bujqit (87,5%) dhe pensionistët (83,3%), ndërsa më rrallë i kanë zgjedhur studentët (59,3%). Vështruar sipas komunave, banorët e Bërvenicës (88,5%) kanë dhuruar më shpesh para, ndërsa banorët e Sarajit, më rrallë (59,3%).

Grafiku 15 Lartësia e donacioneve




- Qytetaret e Bërvenicës, Zhelinës, Sarajit dhe Tearcës më shpesh kanë dhuruar deri në 100 denarë. Siç mund të shihet në grafikonin 15, 19,1% e të anketuarve thanë se vlera e donacionit të tyre ishte deri në 100 denarë. Nga 100 deri në 1000 denarë dhuruan 13,1%, nga 1200 deri në 3000 denarë dhuruan 11,3% e kështu me radhë.

Grafikoni 16 Subjektet e interesit gjatë dhënies së donacioneve




- Në pyetjen „Kujt parapëlqeni t’i dhuroni?“, numri më i madh i të anketuarve, 41,7% nuk kanë bërë dallim dhe u përgjigjen se i dhurojnë të gjithëve. Për 18,1% prioritet janë bashkëqytetarët, ndërsa për 17,5% kjo është familja. 12,2% nuk e kanë problem t’u dhurojnë të panjohurve, ndërsa 5,4% parapëlqejnë t’u dhurojnë miqve.
- Nuk ka përjashtime domethënëse në përgjigjet lidhur me karakteristikat demografike të anketuarve. Njëra që ka të bëjë me përkatësinë etnike e të anketuarve tregon se shumica e maqedonasve etnikë (62,6%) do të dhuronin për të gjithë për dallim nga shqiptarët etnikë të cilët kjo përqindje arrin 37,9%. Në anën tjetër, shqiptarët etnikë (21,1%) më tepër nga maqedonasit etnikë (3,8%) do të dhuronin për bashkëqytetarët.
- As tek komunat, kur shikohen rezultatet e mbledhura, nuk ka përjashtime domethënëse të përgjigjeve, me përjashtim ndoshta të atyre që kanë të bëjnë me dhurimin për bashkëqytetarëti cili është më i shprehur te banorët e komunës së Zhelinës (26,0%) për dallim nga banorët e komunës së Tearcës (11,8%) ku mbështetja për këtë grup të synuar është më e ulët.

Grafiku 17 Koha e donacionit gjatë vitit




- Numri më i madh i të anketuarve (41,8%) do të kishin dhuruar gjatë tërë vitit, ndërsa rreth një e pesta donacionin e lidhin me festën fetare. Për diçka më shumë se një të katërtën e të anketuarve (28,4%) që të dyja përgjigjet janë opsion.
- Maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë dallohen në përgjigjet e kësaj pyetjeje. Një shumicë e madhe e të parëve ose 82,4% dhurojnë gjatë tërë vitit, për dallim nga shqiptarët etnikë prej të cilëve rreth një e treta (33,9%) thanë se dhurojnë gjatë tërë vitit. Në llogari të kësaj, është më i madh numri i shqiptarëve etnikë (25,1%) për të cilët dhurimi lidhet me festën fetare, për dallim nga maqedonasit etnikë të të cilët kjo përqindje është e parëndësishme, më pak se 1%.
- Shumica e punonjësve të institucioneve publike (51,1%) dhe pensionistët (50,8%) do të kishin dhuruar gjatë tërë vitit. Më i vogël është numri i studentëve (30,6%), të angazhuarve në detyrat shtëpiake (30,9%) dhe studentët (31,6%) të cilët do të kishin dhuruar gjatë tërë vitit. Vështruar sipas komunave, shumica e banorëve të komunës së Bërvenicës (59,0%) do të kishin dhuruar gjatë tërë vitit, përderisa në komunën e Tearcës numri i atyre të cilët do të kishin dhuruar gjatë tërë vitit është më i vogël (30,8%).

Grafiku18 Mënyra e parapëlqyer e dhënies së donacionit




- Të pyetur „Si parapëlqeni të dhuroni?“, shumica e të anketuarve (55,5%) thanë „në dorë“. Kutia e donacioneve është përzgjedhje e 15,3 të anketuarve, ndërsa e ngjashme është përqindja e atyre të cilët thanë se parapëlqejnë të paguajnë nëpërmjet xhirollogarisë (14,2%). Dhurimi përmes teledonacionit është përzgjedhje e 3,5% të anketuarve, ndërsa dhurimi përmes blerjes së artikujve është e 2,5% të tyre. Pothuajse e panjohur ose jo e parapëlqyer është blerja e produkteve të markës ose të shërbimeve.
- Dhënia e donacionit në dorë është më pak e pranueshme për maqedonasit etnik (32,1%) për dallim nga shqiptarët etnik (59,9%). Më e pranueshme për maqedonasit etnik është donacioni nëpërmjet xhirollogarisë për ç'gjë janë shprehur rreth një e treta e të anketuarve ose 32,8%, përderisa kjo mënyrë parapëlqehet pothuajse për çdo të dhjetin shqiptar/e etnik (10,7%).
- Pagesa në dorë parapëlqehet më pak edhe për të anketuarit me arsim të lartë të kryer (38,3%) si dhe për punonjësit e institucioneve publike (41,7%). Për dallim nga ata, donacioni në dorë është përzgjedhje e shpeshtë e studentëve (69,4%) dhe të angazhuarit në detyra shtëpiake (65,5%).

Grafikoni 19 Ndërmjetësimi i parapëlqyer gjatë dhënies së donacionit




- Të pyetur „Kujt ose nëpërmjet kujt parapëlqejnë t'i japin donacionet?“ shumica e të anketuarve (60,2%) deklaruan se dëshirojnë ta bëjnë atë drejtpërdrejt aty ku është e nevojshme, gjë që tregon se nuk i parapëlqejnë ndërmjetësuesit. Nga ndërmjetësuesit e mundshëm, kishat dhe komunitetet fetare ndodhen në vendin e parë dhe për to janë përcaktuar 17,3% të anketuarve. Në vendin e dytë janë organizatat qytetare me 6,4%, dhe pastaj Kryqi i Kuq me 3,1%. Nën 3% janë institucionet publike dhe bashkësitë lokale ose komuna.
- Një pakicë e maqedonasve etnikë (42,7%) parapëlqejnë të dhurojnë drejtpërdrejt aty ku është e nevojshme për dallim nga shumica e shqiptarëve etnikë (63,6%). Diçka më tepër se një e treta e maqedonasve etnikë do të dhuronin përmes kishës ose komunitetit fetar, për dallim nga shqiptarët etnikë ku kjo përqindje është 13,8%.
- Donacioni i drejtpërdrejtë parapëlqehet për shumicën e punësuar në institucionet publike (77,4%), ndërsa parapëlqehet diçka më pak për të punësuarit në institucionet private (55,7%). Një e pesta e atyre të institucioneve private do të kishin dhuruar përmes kishës apo komunitetit fetar, për dallim nga të punësuarit në institucionet publike të cilët kjo përqindje është 7,1%.
- Kisha ose komuniteti fetar si ndërmjetësues parapëlqehet më tepër nga banorët e Bërvenicës (25,5%) në raport me komunat e tjera, veçanërisht për banorët e komunës së Zhelinës ku kjo përqindje rezulton 13,0%

Grafiku 20 Mënyra e informimit për veprimet e ndërmarra në komunitet




- Rreth një e treta e të anketuarve për veprimet në komunitet informohen nga miqtë dhe të njohurit e tyre. Për 23,3% të qytetarëve informatat arrijnë drejtëpërdrejt nga kërkuesit e donacioneve, ndërsa çdo qytetar i dhjetë informohet përmes mediave elektronike. Kishat dhe komunitetet fetare janë burime informatash për 9,2% e të anketuarve, ndërsa diçka më e vogël është përqindja (9,0%) për ata që informohen nga mediat e shtypit.
- Qasja në informatat apo shprehja e mënyrës së informimit dallojnë tek të anketuarit. Maqedonasit etnik (24,4%) informohen më shpesh për veprimet në komunitet nga mediat elektronike për dallim nga shqiptarët etnik (7,7%). Të punësuarit në institucionet publike (32,1%) dhe bujqit (36,8%) më shpesh i marrin informatat nga kërkuesit e donacioneve. Nuk ka dallime domethënëse në burimet e informatave të cilat i përdorin të anketuarit nga komunat e ndryshme.
- T'i ndihmohet dikujt që ka nevojë është motivi më i shpeshtë i të anketuarve për të dhënë donacion. Për 19,0% kjo është përvojë personale, ndërsa 12,7% konsiderojnë se kështu është e drejtë. Motivi për 9,7% e të anketuarve është se shteti apo bashkësia lokale nuk bën sa duhet, për atë gjë duhet të përfshihen qytetarët, ndërsa për 9,2% arsyeja është besimi në qëllimet për atë gjë që dhurojnë. Rreth 5,0% të anketuarve udhëhiqen nga emocionet, ndërsa 2,2% konsiderojnë se ashtu e imponon rrethi dhe shoqëria.
- Përvoja personale në masë të madhe i udhëheq banorët e komunës së Bërvenicës (27,5%) se sa banorët e komunës së Zhelinës (11,0%).

Grafiku 21 Motivi për të dhënë donacion




- Qëllimi i donacionit të rreth një të tretës së të anketuarve është jeta më e mirë për të gjithë. Siç mund të shihet nga grafiku 22, rreth një e katërta synon për një shëndet më të mirë për njerëzit, ndërsa 16,9% e qytetarëve dëshirojnë të arrijnë kushte më humane të jetesës për disa persona. Arsimi, të drejtat e grupeve të caktuara të qytetarëve, ambienti jetësor, paqja ndodhen në fundin e listës së synimeve, respektivisht ato i kanë përmendur më pak se 6% e të anketuarve.

Grafiku 22 Qëllimi i donacionit




- Shumica e maqedonasve etnikë (57,3%) me donacionin dëshirojnë ta përmirësojnë jetën për të gjithë. Ky është qëllim i 30,9% të shqiptarëve etnikë. Për afro 10 pp dallohen përgjigjet tek të dyja komunitetet etnike kur bëhet fjalë për qëllimin i cili i përkushtohet krijimit të kushteve më humane për jetën e disa personave, respektivisht për shqiptarët etnikë (18,6%) ky qëllim është më prioritar se sa për maqedonasit etnik (8,4%).
- Sa i përket qëllimit i cili përqëndrohet në shëndetin e njerëzve, ai është vënë në dukje më shpesh nga bujqit (42,1%).
- Nuk ka dallime domethënëse të komunat në raport me vlerat mesatare. Mund të vërehet se ndërmjet komunave ka një diferencë më të madhe se 10 pp kur bëhet fjalë për qëllimin që të përmirësohet jeta e të gjithëve. Banorët e komunave Bërvenicë (40,5%) dhe Tearcë (40,3%) më shpesh udhëhiqen nga ky qëllim, për dallim nga banorët e komunave Zhelinë (29,0%) dhe Saraj (29,5%).
- Përfitimet nga zhvillimi teknologjik ende përdoren rrallë për lehtësimin e mënyrës së dhurimit në vend. Ndryshimet teknologjike u lejojnë qytetarëve të vendeve të zhvilluara me disa „klikime“ që të dhurojnë shumën e dëshiruar në vend. Në Maqedoni filluan më vonë të krijohen hapat e parë të formës së donacionit elektronik, megjithatë me këtë mënyrë të donacionit duhet të merren parasysh të dyja anët: a është e arritshme teknologjia/mjetet për donacionin e tillë dhe vallë qytetarët ndihen të përgaditur për ta përdorur këtë mënyrë të donacionit.
- Rezultatet e donacionit tregojnë se 27,6% e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë do të instalojnë aplikacionin celular për dhurim në telefonin e tyre. Rreth 40% e të anketuarve nuk duan të paguajnë nëpërmjet telefonit. Megjithatë, të anketuarit të cilët kanë thënë nuk dinë si t'i përdorin aplikacionet (23,8%) me kalimin e kohës mund t'u bashkangjiten atyre të cilët pajtohen të përdorin aplikacionin celular për dhurim dhe numri i tyre të bëhet shumicë.

Grafiku 23 Gatishmëria për të dhuruar nëpërmjet aplikacionit celular



- Shumica e maqedonasve etnik (53,4%) pajtohen që ta instalojnë aplikacionin celular për dhurim në telefonin e tyre, për dallim nga 22,7% të shqiptarëve etnik. Kjo reflektohet edhe në përgjigjet e tjera, andaj 46,2% e shqiptarëve etnikë parapëlqejnë të paguajnë me telefon, për dallim nga maqedonasit etnik ku kjo përqindje është më e ulët dhe rezulton 13,0%.
- Niveli arsimor i të anketuarve ka ndikuar në përgjigjet e tyre, andaj mund të vërehet se përgjigjet e atyre që thanë se nuk dinë t'i përdorin aplikacionet zvogëlohen me zmadhimin e nivelin arsimor dhe atë prej 61,4% të të anketuarit me shkollë fillore të pambaruar 11,1% të ata me arsim të lartë të kryer. Nëse pritshmëritë kanë qenë se gatishmëria për pagesë përmes telefonit do të rritet me rritjen e nivelit arsimor, në këtë rast kjo nuk është ashtu, përkundrazi, rezistenca për pagesë nëpërmjet telefonit rritet me rritjen e nivelit arsimor edhe atë rreth 20,5% të të anketuarit me shkollë fillore të pakryer, deri në 42,0% të ata me arsim të lartë të kryer.
- Ndhimesa më e madhe për shfrytëzimin e aplikacionit celular për donacionet do t'i duhej bujqve (36,8%), të angazhuarve në detyrat shtëpiake (37,3%) dhe pensionistëve (44,6%). Sa i përket tablosë nëpër komuna lidhur me këtë çështje, problem më të vogël me pagesën përmes telefonit kanë banorët e Bërvenicës (30,0%) dhe Tearcës (36,5%) për dallim nga bashkëqytetarët e tyre të Sarajit (46,5%) dhe Zhelinës (49,5%).


Grafiku 24 Gatishmëria për të dhuruar nëpërmjet platformës së internetit



- Në temën e ngjashme, kësaj rradhe, të donacionit përmes platformës së internetit, qytetarët u pyetën vallë do të regjistroheshin dhe do të dhuronin përmes saj. Më tepër se një e treta (37,9%) kanë deklaruar se nuk duan të paguajnë përmes internetit. Edhe një e katërta ose 26,8% kanë shprehur dyshime në platformat e këtilla, sepse nuk e dinë se ku shkojnë paratë. Përqindja e atyre të cilët do të regjistroheshin në platformën për të dhuruar dhe do të dhuronin përmes saj është 24,3%.
-
- Edhe në përgjigjet e kësaj pyetjeje pasqyrohet situata e mëparshme, veçanërisht në prizmin e përkatësisë etnike të anketuarve. Maqedonasit etnikë në numër më të madh (45,8%) do të regjistroheshin dhe do të përdornin platformën për të dhuruar, ndërsa ky do të ishte rast me çdo të pestin shqiptar etnik (20,2%). Shqiptarët etnik janë më në numër (41,8%) në mesin e atyre që nuk duan të paguajnë përmes internetit, për dallim nga maqedonasit etnik (17,6%). Ata janë më në numër edhe në mesin e atyre të cilët kanë deklaruar se nuk besojnë në platforma të tilla, për dallim nga maqedonasit etnik të cilët janë 12,2%.


- Edhe këtu ka pasur ndikim arsimit të anketuarve. Disponimi për të dhuruar përmes platformës së internetit rritet me nivelin arsimor 4,5% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri 30,9% te ata me arsim të lartë të kryer. Edhe anasjelltas, mosbesimi ndaj pagesës së internetit rritet me zvogëlimin e nivelit arsimor prej 29,6% te ata me arsim të lartë të kryer deri në 45,5% te ata me shkollë fillore të pambaruar. Të punësuarit në institucionet publike (34,5%) janë më të përgatitur për donacion përmes platformës së internetit, ndërsa bujqit (42,1%) kanë më pak besim ndaj platformave, sepse nuk e dinë ku shkojnë paratë.
- Pagatishmëria që të paguhet përmes platformës së internetit është më e madhe te banorët e Tearcës (41,7%) dhe Sarajit (40,0%), për dallim nga bashkëqytetarët e tyre të komunës së Zhelinës (39,5%) dhe Bërvenicës (30,0%).

Grafiku 25 Shkalla e kënaqësisë me informacionin për përdorimin e donacionit




- Shumica e qytetarëve të komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë (77,1%) janë plotësisht apo deri diku të kënaqur nga informatat për atë se çka ndodh me paratë/të mirat të cilat i dhurojnë. Deri diku ose aspak të kënaqur janë gjithsej 14,7% e të anketuarve.
- Vështruar sipas moshës së të anketuarve, më të kënaqur nga informatat janë qytetarët ndërmjet 30 dhe 39 vjeç. Gjithsej 88,2% janë të kënaqur plotësisht ose deridiku. Edhe këtu arsimit ka ndikim, respektivisht shkalla e kënaqësisë me informacionin rritet prej 65,9% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri në 87,7% te ata me arsim të lartë të kryer. Të punësuarit në institucionet publike janë të kënaqur (88,1%) përderisa bujqit janë të pakënaqur (31,6%).

Grafiku 26 Interesi i përparimit të gjërave për të cilat jepet donacion




- Shumica prej 84,0% e të anketuarve duan të dinë si po përparojnë gjërat për të cilat kanë dhuruar. Në pyetjen sa pajtoheni me deklaratën: Dua të di si po përparon gjëja për të cilën kam dhënë donacion, 47,7% plotësisht, ndërsa 36,3% deri diku janë pajtuar. Numri i atyre të cilët deri diku apo aspak nuk pajtohen është 11,7%.
- Pajtueshmëria, respektivisht interesi për përparimin e gjërave rritet me rritjen e nivelit arsimor prej 61,4% te ata me shkollë fillore të pambaruar deri në 87,7% te të anketuarit me arsim të lartë. Ende më i lartë është te të anketuarit me shkollim të lartë dhe arrin 92,8%. Te bujqit mund të shihet përqindja më e madhe e të anketuarve të cilët deridiku apo aspak nuk pajtohen me deklaratat dhe ai rezulton 31,6%.

Grafiku 27 Shkalla e kënaqësisë për transparencën e aktiviteteve dhuruese



- Ku dhe si janë përdorur paratë apo të mirat materiale nga donacionet dhe sa ato janë efektive është një nga pyetjet më të natyrshme që një donator mund t'i parashtrijë. Që të marrë përgjigje adekuate është e duhur transparenca nga ana e atyre që janë përgjegjës për të menaxhuar me këto para. Të pyetur për kënaqësinë e tyre nga kjo transparenca, rreth një e katërta e të anketuarve thanë se janë shumë të kënaqur, ndërsa 43,0% thanë se janë deri diku të kënaqur. Në anën tjetër, gjithsej 22,2% deklaruan se janë deri diku ose aspak të kënaqur me transparençën.
- Vështruar nga prizmi i moshës së të anketuarve, ata të moshës rreth 30-39 vjeç janë më të kënaqurit (shumë apo deri diku) nga transparenca e aktiviteteve dhuruese, përderisa kjo përqindje, ndonëse në shumicë, është më e ulët te personat e rritur mbi moshën 65 vjeç. Kënaqësia rritet edhe me nivelin arsimor nga 38,6% te ata me arsim të lartë të pakryer në 81,5% te ata që e kanë kryer arsimin e lartë. Në pikëpamje të statusit të punës së të anketuarve, më të kënaqur janë të punësuarit në institucionet publike (79,8%) dhe ata në institucionet private (79,9%), ndërsa më të pakënaqur janë bujqit (42,1%).

Grafiku 28 Përgatitjet para dhënies së donacionit



- Rreth një e treta e të anketuarve deklaruan se para se të japin donacione ata bisedojnë me miqtë dhe të afërmit e tyre që të kuptojnë se çka mendojnë ata për këtë gjë, ndërsa 27,9% thanë se përpiqen të informohen se me çfarë tjetër mund të ndihmojnë, përveç donacionit financiar. Çdo i pesti qytetar i komunave Bërvenicë, Zhelinë, Saraj dhe Tearcë informohet për qëllimin më të madh për të cilin lufton organizata apo ai që kërkon donacione. Rreth 17% nuk bëjnë asgjë nga këto, para se ta japin donacionin e tyre.
- Shumica e maqedonasve etnikë (51,1%) para se të japin donacionet flasin me miqtë dhe të afërmit e tyre, përderisa kjo përqindje të shqiptarët etnikë është 27,8%. Kurse në anën tjetër, shqiptarët etnikë (30,6%) më tepër se maqedonasit etnikë (12,2%) përpiqen të informohen se me çfarë tjetër mund të ndihmojnë, krahas donacionit financiar. Bisedat me miqtë para dhënies së donacioneve shpesh përpiqen t'i bëjnë edhe pensionistët (41,5%).
- Me rritjen e nivelit arsimor e të anketuarve rriten edhe përpjekjet e tyre për të kuptuar me çka tjetër mund të ndihmojnë duke u nisur me 15,9% e të anketuarve me shkollë fillore të pambaruar deri në 33,3% të ata me arsim të lartë të pakryer. Niveli arsimor ka efekt të ngjashëm edhe te ata të cilët duan të informohen për tablonë më të gjerë, respektivisht me rritjen e arsimit rritet niveli dhe interesi për informata të këtilla prej 6,8% me shkollë fillore të pambaruar deri në 24,7% të të anketuarit me arsim të lartë të kryer.
- Të punësuarit në institucionet publike (42,9%) më shpesh se mesatarja përpiqen të kuptojnë se si mund të ndihmojnë edhe më, ndërsa bujqit (31,6%) më shpesh se mesatarja duan të informohen për qëllimin më të madh.

• Përfundime

Shumica e qytetarëve kanë dhuruar në komunitet vitin e fundit. Të anketuarit me arsim të lartë janë më të shumtë në mesin e donatorëve.

Arsyeja më e shpeshtë për të mos dhuruar është mungesa e mjeteve. Rreth 18% nuk kanë as për vete ose ndodhen në gjendje të rëndë ekonomike për ç'gjë nuk mund të dhurojnë.

Dy qëllimet për të cilat më së shpeshti është dhënë donacion vitin e kaluar janë ndihma humanitare dhe shërimi i të sëmurëve. Për ta kanë dhuruar gjithsej 44,4% nga të anketuarit. Në vendin e tretë është ndërtimi i objekteve fetare dhe mbështetja e komuniteteve fetare.

Qytetarët më shpesh kanë dhuruar para dhe kjo shumë më shpesh ka qenë deri në 100 denarë. Të anketuarit më të moshuar e parapëlqejnë më shpesh formën e këtyllë të donacionit.

Numri më i madh dhurojnë për të gjithë. Në vendin e dytë dhe të tretë ndodhen bashkëqytetarët dhe familja.

Dhurimi gjatë tërë vitit është përgjigja më e shpeshtë e të anketuarve për kohën e parapëlqyer kur e japin donacionin. Një e pesta zgjedhin që donacionet t'i japin gjatë kohës së festave fetare.

Shumica dëshirojnë që donacionet t'i japin në dorë. Vetëm 14,2% do të dhuronin përmes xhirollogarisë.

Qytetarët nuk parapëlqejnë ndërmjetësues gjatë donacionit. Megjithatë, nga ndërmjetësuesit e mundshëm, kishat dhe komunitetet fetare ndodhen në vendin e parë, madje më tej vijojnë organizatat qytetare të cilat i kanë zgjedhur 6,4% të anketuarve.

Miqtë, personat e njohur dhe kërkuesit e donacionit janë burimet më të shpeshta të informatave. Çdo i dhjeti informohet përmes mediave elektronike.

Motivet më të shpeshta të donacionit janë dëshira për të ndihmuar dhe përvoja personale. Qëllimi i donatorëve më së shpeshti është jeta më e mirë për të gjithë dhe shëndeti më i mirë për njerëzit.

Ende nuk ka masë kritike për inovacionet teknologjike gjatë dhënies së donacioneve. Aplikacionin celular për të dhuruar do ta instalonin 27,6%, ndërsa 24,3% do të regjistroheshin në platformën e internetit për dhënien e donacioneve.

Shumica janë të kënaqur me informatat për përdorimin e donacioneve. Shkalla e kënaqësisë është më e madhe te të anketuarit më të arsimuar.

Qytetarët duan të dinë si po përparojnë gjërat për të cilat kanë dhuruar dhe shumica janë të kënaqur nga transparenca e dhënë për aktivitetet dhuruese. Gjithsej 84,0% dëshirojnë të dinë si po përparojnë gjërat për të cilat kanë dhuruar. Gjithsej 69,5% janë shumë ose deri diku të kënaqur nga transparenca e përgjigjeve për aktivitetet dhuruese.

Shtojcë 1 Pyetësor

I Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve

1. Kush është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve shoqërore në komunitetin tuaj?

<input type="radio"/> 1	Shteti	1
<input type="radio"/> 2	Sipërmarrjet	2
<input type="radio"/> 3	Vetë qytetarët	3
<input type="radio"/> 4	Komuna	4
<input type="radio"/> 5	Të gjithë të përmendurit	5
<input type="radio"/> 6	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

2. Qytetarët kanë përgjegjësi të:
(janë të mundshme më tepër përgjigje)

<input type="radio"/> 1	Respektojnë ligjet /detyrimet ligjore	1
<input type="radio"/> 2	Marrin pjesë në aktivitete politike jopartiake	2
<input type="radio"/> 3	Të marrin pjesë në aktivitetet vullnetare në komunitet	3
<input type="radio"/> 4	Të marrin pjesë në aktivitete bamirëse	4
<input type="radio"/> 5	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

3. Nevojat shoqërore (problemet) mund të zgjidhen me:

<input type="radio"/> 1	Zhvillim, arsim dhe aftësimin e qytetarëve	1
<input type="radio"/> 2	Kërkesën e përgjegjësisë së shtetit dhe ndikimit në politikat publike	2
<input type="radio"/> 3	Ndihma sociale dhe humanitare për grupet në nevojë	3
<input type="radio"/> 4	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

4. Të shumtit e njerëzve janë:

<input type="radio"/> 1	Solidarë dhe të gatshëm t'u ndihmojnë atyre të cilëve u duhet ndihmë	1
<input type="radio"/> 2	Të kujdesshëm vetëm për veten dhe nuk janë të interesuar për të tjerët, komunitetin dhe vendin	2
<input type="radio"/> 4	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

5. Sa është e arsyeshme për ju t'i shmangeni pagesës së tatimit:

<input type="radio"/> 1	Cdoherë	1
<input type="radio"/> 2	Ndonjëherë	2
<input type="radio"/> 3	Asnjëherë	3
<input type="radio"/> 4	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

6. A ka pasur takime 12 muajt e fundit në të cilat është folur për problemet në bashkësinë tuaj lokale/komunën?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo	2
<input type="radio"/> 3	Nuk di	3
<input type="radio"/> 4	Refuzon të përgjigjet	99

7. Vallë dhe sa keni marrë pjesë në takimet e këtilla?

<input type="radio"/> 1	Nuk kam marrë pjesë	1
<input type="radio"/> 2	Njëherë	2
<input type="radio"/> 3	Disa herë	3
<input type="radio"/> 4	Shumë herë	4
<input type="radio"/> 5	Nuk ka pasur takime	5
<input type="radio"/> 6	Refuzon të përgjigjet	99

8. A janë organizuar vullnetarisht 12 muajt e fundit njerëzit e komunitetit tuaj për të bërë ndonjë gjë të dobishme?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo	2
<input type="radio"/> 3	Nuk di	3
<input type="radio"/> 4	Refuzon të përgjigjet	99

9. Vallë dhe sa herë në 12 muajt e fundit keni marrë pjesë në një aktivitet të tillë?

<input type="radio"/> 1	Nuk kam marrë pjesë	1
<input type="radio"/> 2	Njëherë	2
<input type="radio"/> 3	Disa herë	3
<input type="radio"/> 4	Shumë herë	4
<input type="radio"/> 5	Nuk ka pasur aktivitete	5
<input type="radio"/> 6	Refuzon të përgjigjet	99

10. A e ndihmoni personalisht komunitetin tuaj pa marrë ndonjë kompensim për këtë gjë?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo	2
<input type="radio"/> 4	Refuzon të përgjigjet	99

11. Nëse keni qenë të përfshirë në ndihmën e komunitetit, në cilën fushë?

<input type="radio"/> 1	Kishave dhe komuniteteve fetare	1
<input type="radio"/> 2	Demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës	2
<input type="radio"/> 3	Fëmijëve, të rinjve dhe studentëve	3
<input type="radio"/> 4	Komuniteteve etnike	4
<input type="radio"/> 5	Grave dhe çështjeve gjinore	5
<input type="radio"/> 6	Ambientit jetësor dhe natyrës	
<input type="radio"/> 7	Shëndetit dhe shëndetësisë	
<input type="radio"/> 8	Kulturës dhe artit	
<input type="radio"/> 9	Personave me nevoja të veçanta	
<input type="radio"/> 10	Shoqërive profesionale	
<input type="radio"/> 11	Ndalimit të dhunës dhe tolerancës	
<input type="radio"/> 12	Arsimit dhe shkencës	
<input type="radio"/> 13	Shërbimeve financiare	
<input type="radio"/> 14	Zhvillimit të shoqërisë qytetare	
<input type="radio"/> 15	Zhvillimit rural	
<input type="radio"/> 16	Organizimit të punëdhënësve	
<input type="radio"/> 17	Sindikatave	
<input type="radio"/> 18	Sociale dhe humanitare	
<input type="radio"/> 19	Sportit dhe rekreacionit	
<input type="radio"/> 20	Personave të moshuar	
<input type="radio"/> 21	Të tjera	39
<input type="radio"/> 22	Nuk ka qenë i/e kyçur	
<input type="radio"/> 23	Refuzon të përgjigjet	99

12. Në cilën mënyrë?

<input type="radio"/> 1	Ka paqar anëtarësim	1
<input type="radio"/> 2	Punë vullnetare (pa kompensim)	2
<input type="radio"/> 3	Pjesëmarrje në aktivitete	3
<input type="radio"/> 4	Donacion në para	4
<input type="radio"/> 5	Nuk di/refuzon të përgjigjet	99

13. A keni dhënë donacione (para/të mira) për ndihmën e komunitetit gjatë 12 muajve të fundit?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo	2
<input type="radio"/> 3	Nuk di /Refuzon të përgjigjet	99

14. Nëse nuk keni dhënë donacion, pse keni vepruar kështu?

<input type="radio"/> 1	Nuk besoj se paratë shfrytëzohen në mënyrë adekuate	1
<input type="radio"/> 2	Nuk kam mjete të mjaftueshme	2
<input type="radio"/> 3	Nuk e di si	3
<input type="radio"/> 4	Nuk ka efekt	4
<input type="radio"/> 5	Nuk kishte ku/si	5
<input type="radio"/> 6	Të tjera	6
<input type="radio"/> 7	Nuk di	7
<input type="radio"/> 8	Refuzon të përgjigjet	99

15. Nëse keni dhuruar në 12 muajt e fundit, për ç 'qëllim keni dhuruar?

<input type="radio"/> 1	Ndihmë humanitare	1
<input type="radio"/> 2	Shërimin e të sëmurëve	2
<input type="radio"/> 3	Ndërtimin e objekteve fetare dhe mbështetjes së komuniteteve fetare	3
<input type="radio"/> 4	Ndihmën në shkolla	4
<input type="radio"/> 5	Gara sportive dhe ngjarje	5
<input type="radio"/> 6	Të tjera	6
<input type="radio"/> 7	Nuk di	7
<input type="radio"/> 8	Refuzon të përgjigjet	99

16. Nëse keni dhënë donacione, në çka keni dhënë?

<input type="radio"/> 1	Para	1
<input type="radio"/> 2	Të mira (ushqime, veshje dhe ngj.)	2
<input type="radio"/> 3	Punë mirëbërëse (kohë, përkujdesje për personat e moshuar, dituri)	3
<input type="radio"/> 4	Nuk kam dhënë donacione	4
<input type="radio"/> 5	Nuk di/Refuzon të përgjigjet	99

17. Për kë parapëlqeni të dhuroni?

<input type="radio"/> 1	Familjen	1
<input type="radio"/> 2	Miqtë	2
<input type="radio"/> 3	Bashkëqytetarët	3
<input type="radio"/> 4	Të panjohurit	4
<input type="radio"/> 5	Të gjithë	5
<input type="radio"/> 6	Asnjërin	6
<input type="radio"/> 7	Nuk di/Refuzon të përgjigjet	99

18. Vallë donacioni ndërlidhet me ndonjë festë fetare ose gjatë tërë vitit?

<input type="radio"/> 1	Festë fetare	1
<input type="radio"/> 2	Gjatë tërë vitit	2
<input type="radio"/> 3	Të dyja	3
<input type="radio"/> 4	Asnjë	4
<input type="radio"/> 5	Nuk di Refuzon të përgjigjet	99

19. Tregoni si parapëlqeni të dhuroni?

<input type="radio"/> 1	Në dorë	1
<input type="radio"/> 2	Në kutinë për donacione	2
<input type="radio"/> 3	Në xhirrollogari (me fletëpagesë)	3
<input type="radio"/> 4	Teledonacion (SMS, thirrje)	4
<input type="radio"/> 5	Duke blerë gjësende (ankand, shitore)	5
<input type="radio"/> 6	Duke blerë produkte të markës që do të dhurojnë fitime	6
<input type="radio"/> 7	Duke blerë shërbime (koncerte dhe ngj.) që do të dhurojnë të ardhura	7
<input type="radio"/> 8	Nuk dhuroj	8
<input type="radio"/> 9	Nuk di Refuzon të përgjigjet	99

20. Tregoni kujt ose nëpërmjet kujt parapëlqeni t'ia jepni donacionin?

<input type="radio"/> 1	Drejtëpërdrejt (në dorë) ku është e nevojshme	1
<input type="radio"/> 2	Kishës apo komunitetit fetar	2
<input type="radio"/> 3	Kryqit të kuq	3
<input type="radio"/> 4	Organizatës qytetare	4
<input type="radio"/> 5	Bashkësisë lokale ose komunës	5
<input type="radio"/> 6	Institucionit publik (spitale, shkolla dhe ngj.)	6
<input type="radio"/> 7	Askund	7
<input type="radio"/> 8	Nuk di Refuzon të përgjigjet	99

21. Si informoheni për veprimet në komunitetin tuaj?

<input type="radio"/> 1	Drejtëpërdrejt nga kërkuesit e donacioneve	1
<input type="radio"/> 2	Përmes mediave të shtypit	2
<input type="radio"/> 3	Përmes mediave elektronike	3
<input type="radio"/> 4	Nga kisha/komuniteti fetar	4
<input type="radio"/> 5	Letrave dhe personave të njohur	5
<input type="radio"/> 6	Të tjera	6
<input type="radio"/> 7	Nuk jam i informuar	7
<input type="radio"/> 8	Nuk di Refuzon të përgjigjet	99

22. Ç'është ajo që ju motivon të dhuroni?

<input type="radio"/> 1	Përvoja personale ose përvoja e të afërmeve	1
<input type="radio"/> 2	T'i ndihmoj dikujt që ka nevojë, të ndryshoj jetën e dikujt	2
<input type="radio"/> 3	Konsideroj se kështu është e drejtë	3
<input type="radio"/> 4	Besoj në qëllimet për të cilat dhuroj	4
<input type="radio"/> 5	Shteti, bashkësia lokale nuk bën sa duhet, duhet edhe ne qytetarët të përfshihemi në to	5
<input type="radio"/> 6	Rrethi dhe shoqëria na detyrojnë që të ndihmojmë (presion për të dhënë ndihmë)	6
<input type="radio"/> 7	Prekem emocionalisht nga rrëfimet ose nga publikimet e mediave ose që dëgjoj nga miqtë	7
<input type="radio"/> 8	Të tjera	8
<input type="radio"/> 9	Nuk dhuroj	9

23. Cili është qëllimi juaj më i madh që dëshironi ta arrini kur dhuroni diçka?

<input type="radio"/> 1	Jetë më të mirë për të gjithë	1
<input type="radio"/> 2	Shëndet më të mirë për njerëzit	2
<input type="radio"/> 3	Arsim më të mirë	3
<input type="radio"/> 4	Të drejta më të mëdha për grupe të caktuara	4
<input type="radio"/> 5	Mjedis më të mirë jetësor	5
<input type="radio"/> 6	Kushte më humane për jetesë për disa persona	6
<input type="radio"/> 7	Sa më pak dhunë, paqe	7
<input type="radio"/> 8	Të tjera	8
<input type="radio"/> 9	Nuk di/Refuzon të përgjigjet	9

24. Nëse ka aplikacione celulare për donacione, a do t'i instaloni në telefonin tuaj celular?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo, nuk dua të paguaj nëpërmjet të telefonit	2
<input type="radio"/> 3	Jo, nuk di t'i përdor aplikacionet	3
<input type="radio"/> 4	Jo, të tjera	4
<input type="radio"/> 5	Nuk e di	5
<input type="radio"/> 6	Refuzon të përgjigjet	99

25. Nëse ka ndonjë platformë interneti në të cilën mund të regjistroheni dhe të dhuroni për qëllime të ndryshme, a do të regjistroheshit?

<input type="radio"/> 1	Po	1
<input type="radio"/> 2	Jo, nuk dua të paguaj përmes internetit	2
<input type="radio"/> 3	Jo, nuk besoj në platforma të këtilla dhe nuk di se ku shkojnë paratë	3
<input type="radio"/> 4	Jo, tjetër	4
<input type="radio"/> 5	Nuk e di	5
<input type="radio"/> 6	Refuzon të përgjigjet	99

26. Sa jeni të kënaqur me informatat për atë se çka ndodh me paratë/të mirat që i dhuroni?

<input type="radio"/> 1	I kënaqur tërësisht	1
<input type="radio"/> 2	Deri diku i kënaqur	2
<input type="radio"/> 3	Deri diku i pakënaqur	3
<input type="radio"/> 4	I pakënaqur tërësisht	4
<input type="radio"/> 5	Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	99

27. Dua të di se si po përparon gjëja për të cilën dhuroj

<input type="radio"/> 1	Plotësisht pajtohem	1
<input type="radio"/> 2	Deri diku pajtohem	2
<input type="radio"/> 3	Deri diku nuk pajtohem	3
<input type="radio"/> 4	Fare nuk pajtohem	4
<input type="radio"/> 5	Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	99

28. Sa jeni të kënaqur me nivelin momental të transparencës së aktiviteteve dhuruese – ku dhe si janë dhënë paratë/të mirat dhe sa janë efektive?

<input type="radio"/> 1	Shumë i kënaqur	1
<input type="radio"/> 2	Deri diku i kënaqur	2
<input type="radio"/> 3	Deri diku i pakënaqur	3
<input type="radio"/> 4	Tërësisht i pakënaqur	4 ²
<input type="radio"/> 5	Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	99

29. Para se të dhuroj unë:

<input type="radio"/> 1	Informohem për qëllimin më të madh për të cilin lufton organizata ose ai që kërkon donacione	1
<input type="radio"/> 2	Përpiqem të informohem për çfarë tjetër gjë mund të ndihmoj, krahas donacionit financiar	2
<input type="radio"/> 3	Bisedoj me miq dhe të afërm që të kuptoj se çka mendojnë ata	3
<input type="radio"/> 4	Asnjë	4
<input type="radio"/> 5	Refuzon të përgjigjet	99

Shtojcë 2 Struktura e mostrës

Gjinia	%	Vendbanimi	%
Burrë	48,3	Bërvenicë	24,7
Grua	51,7	Zhelinë	24,7
Mosha	%	Saraj	24,7
18-29	21,0	Tearcë	26,0
30-39	18,7	Statusi i punës	
40-49	20,3	I punësuar në sektorin publik	10,4
50-64	19,5	I punësuar në sektorin privat	21,5
65+	20,5	I vetëpunësuar	7,8
Përkatësia etnike	%	Student	6,0
Maqedon/e	16,2	I/e angazhuar në obligime shtëpiake	13,6
Shqiptar/e	83,0	I/e papunësuar	21,7
Tjerë	0,8	Pensionist	16,0
Arsimi	%	Bujk	2,3
Skollë fillore të pambaruar	5,4	I punësuar në organizatë qytetare	0,7
Fillor	29,6		
I mesëm	44,9		
Shkollë e lartë	8,5		
I lartë	10,0		
Studime të magjistraturës	1,6		